

DEPARTAMENTI I BUXHETIT - BUDZETI
 DEPARTMENT OF FINANCE - LABOUR AND TRANSFERS
 DEPARTAMENTI I BUXHETIT - BUDZETI
 DEPARTAMENTI I BUXHETIT - BUDZETI

Nr. 337-9/2024
 06/04
 03.04.24



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve - Ministarstvo Finansija, Rada i Transfera -
Ministry of Finance, Labour and Transfers

Departamenti i Buxhetit - Budget Department - Budzet Departament

DATE	22.04.2024
REFERENCË	Nr. 51/2024
PËR/ZA/TO:	Nuhi Mani, Zyrtarë Kryesor Financiar, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve
CC:	
PËRMES/PREKO/THROUGH:	Enis Spahiu, U.D Sekretar i Përgjithshëm, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve
NGA/OD/FROM:	Salvador Elmazi, Drejtor i Departamentit të Buxhetit, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Opinion i Departamentit të Buxhetit për vlerësimin e ndikimit buxhetor të Projektligj për Ratifikimin e Amendamentit të Marrëveshjes për Themelimin e Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim ("Marrëveshja") – Neni 1

I nderuar Zt Mani,

Bazuar në kërkesën e Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve (MFPT) për vlerësimin e ndikimit buxhetor të Projektligj për Ratifikimin e Amendamentit të Marrëveshjes për Themelimin e Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim ("Marrëveshja") – Neni 1" formularit për vlerësimin e ndikimit buxhetor të paraqitur nga propozuesi MFPT, obligimit sipas nenit 9 të Ligjit Nr. 03/L-221 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.03/L-04 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë si dhe Nenit 18 të Ligjit Nr. 08/L-260 mbi ndarjet buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2024.

Departamenti i Buxhetit paraqet me sa vijon:

I. ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PROJEKTLIGJIT

Nëpërmjet këtij Ligji ratifikohet Amendamenti i Marrëveshjes për Themelimin e Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim ("Marrëveshja") – Neni 1.

II. OPINIONI I PAVARUR I DEPARTAMENTIT TË BUXHETIT NË VLERËSIMIN E NDIKIMIT BUXHETOR (VNB)

Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve si organ propozues ka përgatitur Vlerësimin e Ndikimit Buxhetor të zbatimit të Projektligjit për “Ratifikimin e Amendamentit të Marrëveshjes për Themelimin e Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (“Marrëveshja”) – Neni 1”, sipas se cilës ky Projektligj nuk ka kosto shtesë buxhetore.

Aktivitetit kryesor që ka të bëjë me nenin I të Projektligjit për “Ratifikimin e Amendamentit të Marrëveshjes për Themelimin e Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim është si në vijim: Për të kontribuar në progresin ekonomik dhe rindërtimin, qëllimi i Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim do të jetë të forcojë tranzicionin drejt ekonomive të orientuara kah tregu i hapur dhe të promovojë iniciativat private dhe ndërmarrëse në vendet e Evropës Qendrore dhe Lindore, që janë të përkushtuara ndaj, dhe që aplikojnë parimet e demokracisë shumë-partiake, pluralizmit dhe ekonomisë së tregut. Varësisht nga kushtet e njëjta, qëllimi i Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim mund të realizohet edhe në Mongoli dhe vendet anëtare të Mesdheut Jugor dhe Lindor; dhe një numër i kufizuar i vendeve anëtare të Afrikës Sub-Sahariane në çdo rast siç përcaktohet nga Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim me votën pozitive të jo më pak se dy të tretave të Guvernatorëve, që përfaqësojnë jo më pak se tre të katërtat e totalit të fuqisë votuese të anëtarëve. Prandaj, çdo referencë në këtë Marrëveshje dhe shtojcat e saj për vendet e Evropës Qendrore dhe Lindor, vendet nga Evropa Qendrore dhe Lindore, vendi (ose vendet) marrës ose vendi anëtar (ose vendet) marrës do t’i referohet Mongolisë dhe secili prej vendeve të tilla të Mesdheut Jugor dhe Lindor dhe Afrikës Sub-Sahariane.

III. PËRFUNDIM

Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve - Departamenti i Buxhetit vlerëson se “Projektligji për Ratifikimin e Amendamentit të Marrëveshjes për Themelimin e Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (“Marrëveshja”) – Neni 1”, nuk ka kosto shtesë buxhetore dhe aktiviteti i paraparë me këtë projektligj ka të bëjë me çështje administrative që ky projektligj duhet të ratifikohet në Kuvendin e Republikës së Kosovës për tu mundësuar vendeve të Afrikës Sub-Sahariane të kenë qasje në shërbimet që ofrohen nga Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim.

Përgatitur nga: Antigona Prenaj, Analiste e lartë e buxhetit

Konfirmoi: Milaim Aliu, Udhëheqës i divizionit të nivelit qendror